



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Më shumë mbështetje dhe lehtësira fiskale për sektorin e peshkimit

2017-11-20 11:23:00



Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Niko Peleshi, sëbashku me dy zëvendësministrat, Roland Kristo dhe Ilir Halilaj, kanë zhvilluar një takim me peshkatarë të liqenit të Shirokës, të Qarkut Shkodër, nje shembull bashkepunimi ne menaxhimin e liqenit ne baze shoqate. Në këtë takim, Ministri ka nënvizuar mbështetjen që do t'i japë Qeveria këtij sektori, duke përmendur skemën e mbështetjes financiare, investimet, programet e ndryshme, bashkëpunimet me Bashkimin Evropian, Programin IPARD etj. Ministri Peleshi ka përmendur ndër të tjera dhe lehtësirat, që i janë krijuar këtij sektori, siç është heqja e TVSH-së për rrjetat dhe për 52 artikuj të mjeteve të bordit të peshkimit. Këto masa do të kenë një efekt më të madh tek peshkatarët e detit, por padyshim, do të ndihmojnë shumë edhe peshkatarët, që ushtrojnë aktivitetin në liqenin e Shirokës.

“Është takimi i dytë që bëj me peshkatarët. Kam takuar që ditët e para të punës, peshkatarët e Durrësit. Aty bëmë një operacion, që u duk si gjë e madhe. Në fakt ishte një detyrim i shtetit, për të çliruar një investim disa milionësh, që është porti i peshkimit i Durrësit, që deri në ato momente ishte i pushtuar nga jahtet e të pasurve. Në fakt, ai është një investim, që është bërë për peshkatarët. Tani i është kthyer peshkatarëve. Ka nevojë për disa investime të tjera, do t'i mundësojmë edhe ne, edhe sipërmarrja me fondet e veta. Ne jemi sot në një ekonomi tregu, secili zhvillon ekonominë e vetë, lufton me rregullat e ekonomisë së tregut, për të mbijetuar, për t'u rritur, për t'u zhvilluar. Detyra e shtetit është që të bëjë, atë që ka në dorë dhe që ka për detyrim, pra të vendosë rregullat e lojës.”

“Dua ta them, që peshkatarët janë një hap përpara fermerëve, apo blegtorëve.” – ka thënë Ministri.

Duke përgëzuar këta peshkatarë, të cilët kanë arritur të organizohen, duke bashkërenduar punët e tyre, Ministri u ka kërkuar që të jenë vigjilentë dhe të mos lejojnë asnjë lloji abuzimi. “...Shumë mirë që ju jeni të organizuar. Forca juaj është shumë e madhe. Do t'ju lutesha, që të mos hezitonit, të më sinjalizoni për çdo veprim apo mosveprim të inspektorëve tanë të peshkimit. Edhe kur veprojnë keq në shkelje të ligjit, edhe kur nuk veprojnë, kur mbyllin sytë.”

“M'u prezantua shqetësimi i parë, që ka lidhje me formalizimin dhe futjen në një sistem kontrolli të peshkimit këtu. Peshku, peshkohet në liqen, pastaj nga peshkimi deri tek tregtimi, hallkat nuk funksionojnë siç duhet. Nuk ka një kontroll, qoftë të sigurisë ushqimore, por qoftë edhe i vërtetimit të origjinës, që duhet të jetë kusht, për çdo njësi tregtare të peshkut.”

“Më vjen mirë, që këtu të paktën, investimi për infrastrukturën është realizuar, falë kontributit të partnerëve tanë, Bankës Botërore. Gjithsesi, në qoftë se duhen mbështetje të tjera, investime, brenda

mundësive që kemi, që këtë vit do t'i kemi më të shumta, ne jemi të gatshëm t'ju mbështesim. Do të kemi në fakt, skemën e mbështetjes financiare për gjithë sektorin, pothuajse dyfish më të madhe, se në të kaluarën.”

Ministri nuk ka harruar të rikujtojë dhe njëherë aksionin e madh, për sigurinë ushqimore dhe masat e marra në kuadër të këtij aksioni.

“Kemi bërë një aksion shumë të madh deri tani. Kemi mbyllur një numër shumë të madh pikash therjeje, të cilat duhet ta themi, ishin liçencuar nga shteti në kundërshtim me ligjin dhe që kishin shkatërruar gjithë investimet e tjera serioze, private.”

“Ne nuk do të lejojmë, që njerëz me uniformën e shtetit të bëjnë biznes, duke përdorur autoritetin e shtetit, sepse autoritetin, duam ta përdorim, për të vendosur rregulla loje, për të hapur vende pune dhe jo për t'ju prishur punë.”

Ka theksuar dhe njëherë Ministri Peleshi.

Takimi u organizua në formën e një bashkëbisedimi, ku Ministri dhe peshkatarët ndanë eksperiencat, problemet, shqetësimet dhe gjetjen e zgjidhjeve të duhura.